



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME VLORË SH.A

Nr. _____, Prot.

Vlorë, më _____.____.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Ndërtimin dhe përmirësimin e furnizimit me ujë të zonës së Kalasë, Ujë Ftohtë, Bashkia Vlorë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45247130-0 - Punime ndërtimi për ujësjellës

VLERA E FONDIT LIMIT:

8,391,306.04 (*tetë milion e treqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e gjashtë .04*) **Lekë Pa TVSH**

Argumentim:

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe V.K.M. Nr 285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 76, sipas të cilit përcaktohet se në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Pas shqyrtimit të të dhënave teknike dhe informacionit të mbledhur të zërave të punimeve, rezultoi vlera e përgjithshme e kontratës. Çmimet e përdorura në preventiv janë në përputhje me çmimet

e "Sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim" i përcaktuar në pikën 2, të nenit 19, të VKM nr. 216, datë 13.04.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Vlore sh.a** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. **Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

- Sipas kritereve të përgjithshme

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2.2. **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (**2023, 2024, 2025**), ku vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Kërkesa për plotësimin e kapacitetit financiar konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar) si dhe në Kreun V, Seksioni III, Nenin 43, pika 2/a dhe pika 3 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (e ndryshuar). Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi. Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t'i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përppjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2026** (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, për të gjitha pikat e ushtrimit të veprimtarisë sipas QKB.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar me VKM nr. 498, datë 1.8.2024; në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin e fundit sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

- Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më e vogël se 29 % e vlerës së përllëgoaritur të kontratës që prokurohet, që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

Ose

- Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se vlera limit e kontratës që prokurohet

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për plotësimin e këtyre kriterëve Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) Në rast se punimet janë kryer me ente publike: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
- v. Formular Vlerësimi nga Investitori sipas shtojcës nr. 9
- vi. Çertifikatën e marrjes në dorëzim të përkohshëm/përfundimtar.
- vii. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.

b) Në rast se punimet janë kryer në sektorin privat: Autoriteti Kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon:

- i. Kontratën e Sipërmarrjes,
- ii. Situacionin përfundimtar të objektit
- iii. Faturat Tatimore të deklaruara në organet tatimore
- iv. Aktin e Kolaudimit të objektit
- v. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 55, pika 4/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë pesë viteve të fundit, të jenë minimalisht për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet ose punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se vlera limit e kontratës që prokurohet, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se disponojnë liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe në liçensë të disponojnë kategoritë e nevojshme për

zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar.

Liçensa profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Punime të Përgjithshme Ndërtimi

- **NP.1 - A** – Punime Germimi ne toke
- **NP-4 - A** Rruge, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
- **NP- 5 - A** Punime nëntokësore, ura e vepra arti
- **NP-7- A** Punime ujësjellëse vepra kullimi e vaditje etj
- **N.P-9 - A** Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime

Punime Speciale Ndërtimi:

- **N.S-1 A**, Punime për prishjen e ndërtimeve

** Për Operatorët e huaj të bëhet njehësimi i liçensës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit në plotësimin e liçensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.*

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e liçensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.**

* Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, Liçensat profesionale duhet t'i paraqesë operatori ekonomik që ka marrë përsipër punimet për të cilat kërkohet Liçensa Profesionale.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për liçencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar si edhe Vendimin nr. 42, date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se liçensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, pikat e liçences dhe kategorite me klasifikimet perkatese caktohen duke u mbështetur ne punimet e parashikuara ne preventivin e objektit dhe ne vleren totale te punimeve per secilen kategori.*

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punes, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoria Licenca NP.1-A “Punime Gërmimi në Tokë”

Kërkesa për kategorinë NP.1-A justifikohet nga volumi dhe natyra e konsiderueshme e punimeve të gërmimit dhe mbushjes së dheut që parashikohen në preventiv. Konkretisht, preventivi parashikon 1,050 m³ gërmim dheu me ekskavator goma në kanale me gjerësi deri në 2 m, si dhe volume të tjera gërmimi me ekskavator dhe me krah, së bashku me punime mbushjeje dhe transporti të dheut. Këto punime janë pjesë thelbësore e realizimit të kanalit për vendosjen e rrjetit të ri të ujësjellësit dhe kërkojnë kapacitet profesional të përshtatshëm për punime gërmimi.

Licenca NP.4-A “Rrugë, Autostrada, Mbikalime, Hekurudha, Tramvai, Metro, Pista Aeroportuale”

Kërkesa për kategorinë NP.4-A lidhet me punimet e rikthimit të infrastrukturës rrugore pas ndërhyrjes në rrjetin e ujësjellësit. Në preventiv parashikohen shtresë çakëlli mbeturine kave, shtresë stabilizanti, mbushje me material të germuar në trupin e rrugës, si dhe shtresë binderi 6 cm dhe asfaltobeton 4 cm me makineri. Gjithashtu parashikohen punime prishjeje të trotuareve dhe rikonstruksion i tyre. Për realizimin korrekt të këtyre punimeve dhe rikthimin e rrugës në gjendjen e parashikuar në projekt kërkohet kapacitet profesional për punime të kësaj natyre.

Licenca NP.5-A “Punime Nëntokësore, Ura dhe Vepra Arti”

Kërkesa për kategorinë NP.5-A lidhet me karakterin nëntokësor të ndërhyrjes, pasi objekti përfshin hapjen e kanaleve dhe realizimin e veprave të lidhura me rrjetin nëntokësor të ujësjellësit. Në mënyrë të veçantë, preventivi parashikon pus kontrolli me përmasa 1.5 × 1.5 × 1 m, punime betoni C16/20, C25/30 dhe C20/25, si dhe punime hekur betoni. Këto punime kërkojnë zbatim të kontrolluar të elementëve konstruktivë dhe veprave nëntokësore të lidhura me rrjetin.

Licenca NP.7-A “Punime Ujësjellësa, Vepra Kullimi dhe Vaditje”

Kërkesa për kategorinë NP.7-A është e lidhur drejtpërdrejt me objektin kryesor të kontratës, i cili është rikonstruksioni i rrjetit të ujësjellësit. Preventivi përfshin furnizimin dhe instalimin e sasive të konsiderueshme të tubacioneve PE100 RC PN10, konkretisht Ø160 mm, Ø90 mm, Ø75 mm, Ø63 mm dhe Ø50 mm, si dhe elementë të tjerë të rrjetit, ndër të cilët saraçineska, hidrantë nëntokësorë dhe mbitolësorë, rakorderi, fllanxha, adaptorë, xhunto dhe pajisje matëse uji. Për këtë arsye, kërkesa për NP.7-A është kriteri kryesor profesional që lidhet me natyrën dhe objektin e kontratës.

Licenca NP.9-A “Punime Mbrojtje Lumore, Sistemime Hidraulike dhe Bonifikime”

*Kërkesa për disponimin e kategorisë NP-9/A argumentohet nga karakteri hidraulik i veprës dhe nga punimet e parashikuara për ndërtimin, rikonstruksionin dhe funksionalizimin e sistemit të ujësjellësit, duke përfshirë elementët e kontrollit, rregullimit, komandimit dhe shpërndarjes së ujit në rrjet. Për shkak të kompleksitetit dhe karakterit hidraulik të ndërhyrjes, kërkohet që operatori ekonomik të disponojë kategorinë **NP-9/A**, si garanci e kapacitetit profesional për realizimin e punimeve hidraulike të parashikuara në kontratë.*

Licenca NS.I-A – Punime për prishjen e ndërtimeve

Kërkesa për kategorinë NS.I-A justifikohet nga punimet konkrete të prishjes që janë pjesë e kontratës. Preventivi parashikon 21 m³ prishje të shtresave të betonit, 80 m² prishje trotuari dhe 30 ml heqje/çmontim të bordurave ekzistuese. Këto punime janë të nevojshme për realizimin e ndërhyrjes në rrjet dhe për rikthimin e mëposhëm të sipërfaqeve të dëmtuara. Për këtë arsye kërkohet që operatori ekonomik të ketë kapacitetin profesional të nevojshëm për kryerjen e punimeve të prishjes në mënyrë të kontrolluar dhe të sigurt.

2.3.3 Referuar preventivit, grafikut, specifikimeve teknike si dhe punimeve ndertimore, Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- 1 (një) ing. Ndërtimi

-1 (një) Ing Hidroteknik

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

1. Kontratë pune të vlefshme,
2. Diplome,
3. Listepagesat e shoqërisë për muajn e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, ku duhet të figurojnë stafi i mësipërm
4. CV ;

Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM – së 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar përsa i takon ndalimeve të dypunësimit. Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklaratimet e operatorit ekonomik në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Operatorët ekonomik duhet të caktojë me anë të një dekaratë Drejtuesin Teknik të punimeve i cili duhet të jetë i përfshirë në license e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinier Hidroteknik:** Kërkesa për një Inxhinier Hidroteknik argumentohet nga fakti se objekti përfshin ndërtimin e veprave të furnizimit me ujë, linjave të transmetimit dhe veprave hidraulike shoqëruese. Prania e Inxhinierit Hidroteknik garanton realizimin korrekt të punimeve të ujësjellësit sipas projektit dhe standardeve teknike në fuqi.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet/Markshajder/Topograf.
- 1 (nje) Inxhinier Gjeoteknik (me kontrate bashkepunim)
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

1. Kontratë pune të vlefshme,
2. Diplome,
3. Listepagesat e shoqërisë për muajn e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, ku duhet të figurojnë stafi i mësipërm

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky numër është llogaritur analitikisht në baze të zerave të preventivit.

Inxhinier Gjeodet / Markshajder / Topograf: Kërkohet për piktimin e aksit të rrjetit, përcaktimin dhe kontrollin e kuotave, pozicionimin e tubacioneve dhe puseta, si dhe verifikimin e matjeve të punimeve të realizuara. Kjo lidhet me shtrirjen nëntokësore të rrjetit dhe punimet e gërmimit të kanaleve.

Inxhinier Gjeoteknik: Inxhinieri Gjeoteknik synon garantimin e kontrollit të kushteve të terrenit, vlerësimin e sjelljes së materialeve të gërmuara dhe të mbushjes, si dhe kontrollin teknik të punimeve të ngjeshjes dhe stabilitetit të kanaleve dhe shtresave të rikonstruksionit. Kërkesa për 1 (një) Inxhinier Gjeoteknik konsiderohet proporcionale me natyrën dhe volumen e punimeve të gërmimit, mbushjes dhe ngjeshjes të parashikuara në preventiv dhe lidhet drejtpërdrejt me garantimin e cilësisë dhe sigurisë së zbatimit të punimeve.

Inxhinier Elektrik: është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën e punimeve të objektit. Gjatë zbatimit të punimeve të gërmimit dhe shtrirjes së rrjetit të transmetimit, sipas specifikimeve teknike, mund të hasen dhe të kërkohej mbrojtja e rrjeteve ekzistuese elektrike dhe kablllove energjetike. Gjithashtu, kontraktori duhet të sigurojë furnizimin me energji elektrike të kantierit dhe funksionimin e pajisjeve përkatëse. Për këtë arsye, prania e një Inxhinieri Elektrik është e nevojshme për mbikëqyrjen teknike të këtyre proceseve, garantimin e sigurisë gjatë punimeve dhe shmangien e dëmtimeve të infrastrukturës elektrike ekzistuese.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

a.1 (një) Teknik Nërtimi të vërtetuar me një document që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diploma), lëshuar nga institucione (Shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose ekuivalent, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucionet ekuivalente si dhe kontratën e punës.

b. 2 (dy) Shofer të pajisur me lejen e drejtimit përkatëse, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, kontratë individuale pune. (në rastin kur punonjësit Shofer janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohej të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.)

c. 2 (dy) buldozerist të specializuar për drejtimin e mjeteve të rënda dhe për këtë duhet të paraqesin dëshmi nga Drejtoria e Shërbimit të Transportit Rrugor, dëshmi kualifikimi sigurimi teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente, kontratë individuale pune. (në rastin kur punonjësit Manovrator janë të kontraktuar me kontratë pune, respektivisht për mjetet e marra me qera, nuk kërkohej të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.)

d. 2 hidraulikë duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit

e. 1 karpentier duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit

f. 1 hekurkthyes duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për muajin e fundit

Per punonjesit e kualifikuar te ndertimit te paraqitet Certifikatat/diplomat/deshmia te leshuara nga institucione publike/private te licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH “I ndryshuar.

Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.

Kur mjeti bashkë me drejtuesin merren me qira për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

-Deklaratë nga operatori ekonomikë se në rast të shpalljes fitues do të paraqes kontratë pune me shoferat të cilët detyrimisht duhet të jetë i pajisur me Dëshmi Aftësie Profesionale të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Leje drejtimi (*Mos sjellja e kësaj kontrate apo dhe e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor pas shpalljes fitues të këtij operatori përbën kusht për s'kualifikimin e tij nga procedura dhe shpalljen si operator jo korrekt nga Autoriteti Kontraktor*)

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur për çdo zë punimesh, bazuar në afatin përkatës të grafikut të punimeve. Kërkesa që punonjësit të kenë “Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme)” të lëshuara nga organizma të akredituara për këtë qëllim në Republikën e Shqipërisë është bërë duke u bazuar në ligjin Nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe VKM – në Nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores Për sigurinë në kantier” Në kriterin mësipërcituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar **punonjës të specializuar/të kualifikuar** për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Nisur nga punimet e parashikuara të zbatimit, në kriteret e veçanta janë kërkuar punëtorët e kualifikuar si më sipër si dhe numri i kërkuar për çdo specialist është minimumi i mundshëm për kryerjen e këtyre punimeve. Kërkesa e paraqitjes së “Diploma/çertifikata/dëshmi të arsimit profesional” të lëshuara nga institucionet të akredituara buron nga zbatimi i Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Shoferi** është i nevojshëm për manovrimin e mjeteve (kamionave) që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zbërthimi zë më zë i preventivit, afatit të punimeve si dhe sasisë së materialeve që do të transportohen rezultojnë të nevojshëm 2 shoferë.
- **Buldozerist** është i nevojshëm për manovrimin e mjeteve të rënda që do të përdoren gjatë zbatimit të punimeve. Bazuar në orët e punës që dalin nga zbërthimi zë më zë i preventivit, afatit të punimeve si dhe sasisë së materialeve që do të transportohen rezultojnë të nevojshëm 2 buldozerist.
- **Hidraulikët** janë të nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve. Objekti është rrjet ujësjellësi dhe ka shumë elementë hidraulikë: tubacione, saraçineska, hidrantë, rakorderi etj. Bazuar në orët e punës që dalin nga zbërthimi zë më zë i preventivit, afatit të punimeve si dhe sasisë së materialeve që do të transportohen rezultojnë të nevojshëm 2 hidraulikë.
- **Karpentieri** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, pasi ka pinime beton C16/20, C25/30 dhe punime betonarme

- **Hekurkthyes** është i nevojshem për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivit të punimeve. Ka 0.4 ton punime hekur betoni.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- **1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë"** në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.
- **1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë "Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave"** e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqeri te akredituara ose nga ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, Per kete duhet te paraqitet certifikata e tranimit si ekspert per dhenien e ndihmes se pare dhe nderhyrjes ndaj emergjencave" e dhene nga nje organizem i licencuar,shqiptar ose i huaj, kontrata e punes, si dhe te figuroje ne listpagesat e shoqerise per 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike,grupimi duhet te kete pjese te stafit te tij 1 nje punonjës " Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave")
- Operatorët ekonomik të kenë min. 1 (një) punonjës të pajisur me çertifikatë **"Specialist për testimin e performances te produkteve te ndertimit"**, leshuar nga Instituti Ndertimit, Ministria Puneve Publike dhe Transportit. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik te paraqes Certifikaten te leshuar nga Instituti Ndertimit, Ministria Puneve Publike dhe Transportit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c , të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar , me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për te zbatuar objektin e prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që

punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve.

- *Për sa më lart, punonjësi i cili është i certifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të cënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.*
- *Prania e një punonjësi të trajnuar dhe të certifikuar për dhënien e ndihmës së parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave kontribuon në garantimin e sigurisë së punonjësve dhe menaxhimin e situatave emergjente gjatë zbatimit të kontratës. Për shkak të përdorimit të makinerive të rënda, punimeve të gërmimit dhe punimeve në kantier, ekziston nevoja për të garantuar reagim të menjëhershëm dhe të përshtatshëm në rast dëmtimi apo emergjence deri në marrjen e ndihmës së specializuar.*
- *Kërkesa për 1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë "Specialist për Testimin e Performancës së Produkteve të Ndërtimit" justifikohet nga natyra dhe larmia e materialeve dhe produkteve të ndërtimit që parashikohet të përdoren dhe të vendosen në vepër gjatë zbatimit të kontratës. Në preventiv parashikohet furnizimi dhe vendosja në vepër e sasive të konsiderueshme të tubacioneve PE100 RC PN10 në diametra të ndryshëm, hidrantëve, saraçineskave, rakorderive, fllanxhave dhe elementëve të tjerë të rrjetit të ujësjellësit. Gjithashtu parashikohen punime me beton të klasave C16/20, C20/25 dhe C25/30, hekur betoni, shtresa stabilizanti, binderi dhe asfaltobetoni. Për shkak të rëndësisë së këtyre materialeve për funksionimin, qëndrueshmërinë dhe cilësinë e veprës së realizuar, është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë kapacitetin profesional për të kontrolluar dhe verifikuar performancën dhe përputhshmërinë e produkteve të përdorura me kërkesat e projektit dhe specifikimet teknike.*

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë një numër jo më pak se 20 (njëzet) punonjës të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit (duke përfshirë dhe stafin teknik të sipërcituar) nga data e zhvillimit të tenderit.

Për t'a vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore/ose Tatimore
- Listpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e kërkuar më sipër dhe të jenë të konfirmuara nga Dega Rajonale Tatimore ku është i regjistruar subjekti.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin".

Argumentimi : *Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç), të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar si dhe referuar grafikut të punimeve të hartuar nga projektuesi, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Numri i punonjësve është*

*vendosur bazuar në sasi të e çdo zëri punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate, pasi nga zbërthimi i zërave të preventivit dhe afati i parashikuar i punimeve janë gjithësej **3486 orë pune punëtori**.*

*Referuar grafikut të punimeve do të realizohen 352 ore pune (2 muaj *22 dite* 8 ore).*

*Referuar preventivit dhe grafikut të punimeve nevojiten **10 punonjës**, dhe **4 (shofer + manovrator)** ku përfshirë dhe stafin Teknik nevojiten në total të paktën **20 (njëzet) punonjës**.*

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qira mjetet e domosdoshme për realizimin e kontratës si me poshtë :

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1.	Presë Asfalti	në pronësi ose me qira	Copë 1
2.	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
3.	Autobitumatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
4.	Rul	në pronësi ose me qira	Copë 1
5.	Grejder	në pronësi ose me qira	Copë 1
6.	Bitumatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1
7.	Autobot uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
8.	Ekskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
9.	Minifadrom me targa	në pronësi ose me qira	Copë 1
10.	Dumper me targa	në pronësi ose me qira	Copë 1
11.	Kamion vetshkarkues 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
12.	Kamion me vinç	në pronësi ose me qira	Copë 1
13.	Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5- 5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
14.	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
15.	Matrapik	në pronësi ose me qira	Copë 1

16.	Aparat ngjitje tubo elektrofuziv	në pronësi ose me qira	Copë 1
17.	Dedektor rrjetjesh i paisur me dedektor të levizshëm me GPRS dhe kamer inspektimi (Pajisja të shoqërohet me foto dhe katalog)	në pronësi ose me qira	Copë 1
18.	Makine shpimi horizontale për instalim tubi me çarje për zëvendësim kolektorësh ekzistues (Pipe bursting)	në pronësi ose me qira	Copë 1
	Mjete mbrojtëse		
1.	Kokore	në pronësi	Copë 20
2.	Jelek	në pronësi	Copë 20
3.	Kuti Ndihme e shpejt	në pronësi	Copë 2

Për përmbushjen e këtij kushti, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë sipas formës së disponimit të mjeteve/ makinerive dhe pajisjeve të kërkuara më lart, në seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të shtojcës 8 në DST, dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, duhet të paraqiten:

Për mjetet me goma që shënohen në rregjistra publike duhet të paraqitet dokument që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit dhe foto e dukshme të mjetit.

Për mjetet e siguruar me qira, të paraqitet kontrata e lidhur për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar plus dokumentat që vërteton Rregjistrimin e mjetit (*leje qarkullimi*), Çertifikatën e Kontrollit Teknik (*të vlefshme*), Siguracionin e mjetit (*të vlefshme*), Taksat e paguara, Leje e transportit dhe Foto e dukshme të mjetit.

Për pajisjet/ makineritë në pronësi të shoqërohen me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

Për pajisjet/ makineritë me qera të paraqitet kontrata e lidhur për këtë objekt, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt e këtij prokurimi, shoqëruar me Akt - Pronësie origjinal ose fotokopje të noterizuar (*kontrata shit-blerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi*) dhe Foto e dukshme të pajisjes/ makinerisë (*të paktën 1*).

- Operatori/Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura do të angazhohen në këtë objekt prokurimi. Autoriteti Kontraktor gezon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë disponueshmërinë e këtyre mjeteve si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

- **Presë Asfalti** - Kërkohet për realizimin e punimeve të prishjes dhe prerjes së sipërfaqeve të asfaltuara gjatë ndërhyrjes në rrugë dhe rikthimit të tyre pas vendosjes së rrjetit.
- **Autobetoniere** - Kërkohet për realizimin e punimeve të betonit dhe betonarmesë të parashikuara në preventiv, përfshirë betonet C16/20, C20/25 dhe C25/30
- **Autobitumatrice** - Kërkohet për realizimin e punimeve asfaltike
- **Rul** - Kërkohet për realizimin e punimeve të ngjeshjes së shtresave të çakëllit, stabilizantit, materialit të mbushjes dhe shtresave asfaltike.
- **Grejder** - Kërkohet për realizimin e punimeve të përhapjes dhe profilimi i materialeve të shtresave rrugore, veçanërisht stabilizantit dhe materialeve të trupit të rrugës
- **Bitumatrice** - Kërkohet për realizimin e punimeve të asfaltimit.
- **Autobot uji** - Kërkohet për realizimin e punimeve të lagjes dhe kontrollin e lagështisë gjatë punimeve të mbushjes dhe ngjeshjes së shtresave rrugore.
- **Ekskavator** - Kërkohet për realizimin e punimeve, pasi parashikon rreth 1,050 m³ gërmim me ekskavator në kanale, përveç gërmimeve të tjera.
- **Minifadrom me targa** - Kërkohet për realizimin e punimeve të ngarkim, sistemim dhe lëvizje të materialeve dhe dheut gjatë punimeve.
- **Dumper me targa** - Kërkohet për realizimin e punimeve të sistemim dhe lëvizje të materialeve dhe dheut gjatë punimeve.
- **Kamion vetshkarkues 20 ton** - Kërkohet për realizimin e punimeve të transporti i dheut dhe materialeve të ndërtimit të parashikuar në preventiv
- **Kamion me vinç** - Kërkohet për realizimin e punimeve të transporti i dheut dhe materialeve të ndërtimit të parashikuar në preventive, si dhe për transportin dhe shkarkimin/ngarkimin e tubacioneve, elementëve hidraulikë dhe materialeve të tjera.
- **Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5- 5 ton** të transporti i dheut dhe materialeve të ndërtimit të parashikuar në preventive si dhe për transportin e materialeve dhe pajisjeve të ndryshme në kantier
- **Gjenerator** – Kërkohet për sigurimin e energjisë elektrike në kantier për pajisjet dhe mjetet që kërkojnë furnizim elektrik, veçanërisht në zona ku nuk garantohet furnizim i vazhdueshëm.
- **Matrapik** - Kërkohet për realizimin e punimeve të prishjes së betonit dhe trotuarit të parashikuara në preventiv.
- **Aparat ngjitje tubo elektrofuziv** Kërkohet për realizimin e punimeve të vendosje dhe bashkimin e tubacioneve PE100 RC në disa diametra
- **Dedektor rrjetesh i paisur me dedektor të levizshëm me GPRS dhe kamer inspektimi (Pajisja të shoqërohet me foto dhe katalog)** - Kërkohet për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv
- **Makine shpimi horizontale për instalim tubi me çarje për zëvendësim kolektoresh ekzistues (Pipe bursting)** - Kërkohet për realizimin e punimeve Instalim tubi me çarje për të zëvendësuar tubin ekzistues për kalimin e tubacioneve.

2.3.9 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombetare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme” ose të kete kontrate shërbimi noteriale për objektin konkret me shoqëri të licensuara. Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”). Licenca duhet të shoqërohet me akt miratimin.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,*

Kërkesa që operatori ekonomik të jetë i pajisur me licencën përkatëse për veprimtarinë e menaxhimit të mbetjeve jo të rrezikshme, ose të ketë kontratë të vlefshme shërbimi me një subjekt të licensuar për grumbullimin, ruajtjen dhe transportimin e tyre, justifikohet nga natyra e punimeve objekt kontrate dhe nga detyrimi për menaxhimin në mënyrë të ligjshme dhe të kontrolluar të mbetjeve që krijohen gjatë zbatimit të punimeve.

Konkretisht, preventivi parashikon punime që gjenerojnë mbetje ndërtimore dhe inerte, ndër të tjera prishje të shtresave të betonit në sasinë 21 m³, prishje trotuari në sasinë 80 m², çmontim/heqje bordurash ekzistuese në sasinë 30 ml, si dhe gërmime të konsiderueshme për hapjen e kanaleve, përfshirë rreth 1,050 m³ gërmime me ekskavator. Gjithashtu, gjatë realizimit të punimeve do të krijohen mbetje dhe materiale të tepërta nga procesi i gërmimit, prishjes, ndërtimit dhe rikonstruksionit të sipërfaqeve.

Për këtë arsye, është e nevojshme që operatori ekonomik të garantojë që mbetjet e krijuara gjatë zbatimit të kontratës të grumbullohen, ruhen përkohësisht, transportohen dhe dorëzohen për trajtim/menaxhim në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi, duke shmangur depozitimin apo transportimin e tyre në mënyrë të pakontrolluar.

Kërkesa synon garantimin e respektimit të legjislacionit mjedisor, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik, si dhe menaxhimin e kontrolluar të mbetjeve që do të krijohen gjatë realizimit të punimeve.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë së bashku me preventivin dhe analizën teknike për të gjithë zërat e preventivit të ofertës. Mosparaqitja në formën e kërkuar përbën kusht për skualifikim. Bazuar në VKM nr.514 datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,*

2.4.1 Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si me poshtë:

- **ISO 9001:2015** (Sistem i Menaxhimit të Cilësisë) (e vlefshme)/ose/ekuivalent
- **ISO 14001:2015** (Sistem i Menaxhimit Mjedisor) (e vlefshme)/ose/ekuivalent
- **ISO 45001:2018** (Sistem i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë) (e vlefshme)/ose/ekuivalent

Nese certifikatat jane ne gjuhe te huaj, ato te paraqiten te perkthyer dhe te noterizuara ne gjuhen zyrtare shqipe. Keto certifikata te jene leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Certifikatat duhet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mesiperme sipas natyrës së punimeve që do të marrë persiper të realizojë, referuar kontratës së bashkepunimit të nënshkruar.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” në të cilët përcaktohet: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **aftësinë teknike dhe profesionale**;...Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë **se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike**, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën **sipas një standardi të përshtatshëm cilësie**”

Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë” të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.**”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se: Autoriteti kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar çertifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime.

- **Certifikatë ISO 9001:2015 - Certifikim për menaxhimin e cilësisë ose ekuivalente** (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilesi dhe standarte europiane e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizma ndërkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qenë se kjo lloj certifikate ISO-mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe cdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kësaj ISO; Ne rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE

- **Certifikatë ISO 14001:2015 - Sistemi i Menaxherial i Mjedisit ose ekuivalente** (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.
- **Certifikatë ISO 45001:2018 - Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë ose ekuivalente**, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evluar ndër vite do te pranohet edhe çdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO. Në rast se oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh ky kriter plotësohet nga të gjithë anëtarët e BOE.

AK rezervon te drejten e verifikimit te deklarimeve per punojesit e mesiperme, cdo informacion i rreme apo i devijuar nga kerkesat e mesiperme do te jete kusht per skualifikimin e ofertes.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE:

*Shënim: Specifikimet teknike dhe termat e references, për shërbimet objekt prokurimi, shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha shërbimeve dhe standardeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të shërbimit, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, preventivi, grafiku dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DST.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP (www.app.gov.al).

Njesia e Prokurimit
